



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:144116

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05433992

Ac.nr.5208/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, Rruga “Nënë Tereza”, nr.36, ndaj debitorit Q.G nga V..., Rruga “D.K”, me bazë juridike borxh në shumë prej 1,141.69 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit CPP.nr.591/20 të datës 02.02.2021, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri, me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Q.G nga V..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri, CPP.nr.591/20 i datës 02.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri, me aktvendimin e atakuar CPP.nr.591/20 të datës 02.02.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Q.G nga V..., Rruga “D.K”, dhe ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit privat Atip Mustafa nga Vushtrria P.nr.1566/18 i datës 19.12.2018.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të mos ndriçimit të fakteve relevante në këtë çështje civile, aplikim e gabuar të provave materiale si dhe aplikim e gabuar të se drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit të prishet aktvendimi i shkallës së parë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat afarist për pagesat e shërbimeve komunale për energji elektrike, nr.DMI 9029698, në shumën prej 1,141.69 euro, për periudhën 01.03.2009 deri me 20.03.2013. Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin me urdhrin P.nr.1566/18 të datës 19.12.2018, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim me datën 24.12.2018, ndërsa kreditori me datën 04.01.2019, ka paraqitur përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin CPP.nr.14/19 të datës 04.02.2019, ka pranuar në tersi si të bazuar prapësimin e debitorit Q.G. Kundër këtij aktvendimi kreditori ka paraqitur ankesë e cila është aprovuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.2130/19 të dt.19.06.2020. Në ri procedure, Gjykata e shkallës së parë duke vepruar konform sugjerimeve të gjykatëse ankimore si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: ekstrakti i verifikuar nga librat afarist për pagesat e shërbimeve komunale. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç ekstrakti nr. DMI 9029698, në shumën e kërkuar për pagesë prej

1,141.69 euro. Ekstrakti është i përshtatshëm për përbarim ngase është dorëzuar në origjinal, në të është cekur kreditori dhe debitori, objekti, lloji dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, andaj, nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Sipas dispozitës së nenit 368, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së: përcaktohet se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin dhe se pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”, ashtu që në rastin konkret debitori ka bërë pagesa të cilat kanë ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit dhe se i njëjti ka lidhur kontratë për pagesën e borxhit si dhe deklaratë mbi dakordimin e borxhit, me çka është bërë edhe pranimi i borxhit nga ana e debitorit.

Pretendimi ankimor i debitorit se i njëjti ka lidhur marrëveshje me kreditorin dhe ka paguar një pjesë të borxhit mirëpo me pastaj kur është përkeqësuar gjendja e tij materiale e ka ndërpre pagesa pa dëshirë, ndërsa gjykata shkallës së parë pa e ftuar paraqitësin e kërkesës për tu deklaruar ka marrë vendim arbitrar. Gjykata e Apelit vlerëson se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, ngase debitori me kreditorin ka arritur marrëveshje që të bëjë pagesën e borxhit në shumë prej 1,265.69 euro, në 6 këste, sipas programit të pagesës së borxhit, me qëllim që të përfitojë faljen e borxhit të grumbulluar deri më datë 31.12.2008 në shumë prej 1,084.20 euro, ku sipas nenit 3 të kontratës kanë paraparë se “në rast se përfituesi shkakton 3 pagesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e pa paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”, në rastin konkret debitori me dt.11.07.2016 ka lidhë kontratë për pagesën e borxhit dhe deklaratën për dakordimin e borxhit me kreditorit, kurse me datën 31.03.2017 ka bërë pagesën e energjisë kësti i 4, dhe pastaj e ka ndërpre pagesën duke mos ju përmbajtur kontratës në fjalë, Andaj, në rastin konkret debitori nuk i është përmbajtur marrëveshjes dhe kreditori i ka rikthyer të njëjtit të gjithë borxhin e vjetër, duke i zbritur vlerën e pagesave të bëra, ashtu që kreditori ka kërkuar borxhin si në propozimin për përbarim. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5208/2021 me datë 07.03.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci